

VENDIM
Nr.612, datë 2112.1999

**PËR LLOGARITJEN E KOEFICIENTIT PËRFUNDIMTAR TË KTHIMIT TË SHUMAVE
KREDITORËVE TË SHOQËRISË “ARSED” SHPK NË ADMINISTRIM DHE FILLIMI I
PROCESIT TË KOMPENSIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe të neneve 3,4 dhe 8, pika 3, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe të neneve 3,4 dhe 8, pika 3, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Shuma e detyrimit të mbetur (borxhi), që shoqëria huamarrëse “Arsed” shpk në administrim ka ndaj kreditorëve të saj, llogaritet në 42 423 922 (dyzet e dy milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e njëzet e dy) lekë.

2.Vlera financiare, gjendje në bankë, e përfituar nga shitja e asetit në tenderin publik dhe e depozituar në llogarinë për shlyerje të kreditorëve është 21 215 000 (njëzetë e një milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

3.Shpërndarja e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Arsed” shpk në administrim, kryhet nga Banka e Kursimeve, dega Tiranë, sipas listës bashkëlidhur, në përputhje me vendimin e marrë nga administratori.

4.Fondet financiare, për mbulimin e shpenzimeve, që do të kryhen nga Banka e Kursimeve në shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Arsed”, shpk mbulohen nga grupi Mbikqyrës, nga zëri i shpenzimeve të planifikuara në buxhet.

5.Ngarkohen Ministria e Financave, Banka e Kursimeve, Grupi Mbikqyrës dhe administratori i shoqërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir M eta